



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 367/3 Prot.

Tiranë, më 20.02.2026

**VENDIM**

Nr. 14 Datë 20.02 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E TARIFËS PËR NJË ORË TRAJNIMI  
/PARAPËRGATITJE/RAPORTIM/KOORDINIM PËR TRAJNIME PËR  
ZHVILLIM PROFESIONAL”**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në neni 43 të Statutit të UST-ës, në mbështetje të Vendimit nr. 188, datë 13.03.2019, të KM "Për ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet, pika 2, në Udhëzimin nr. 16, datë 22,07,2024 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", në Vendimit nr.647, datë 05.10.2022, të KM "Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të KM "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë" i ndryshuar, paragrafi I, pika 2, në shkresën e Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar me nr. 209 prot., datë 10.02.2026 me subjekt "Kërkesë për informacion mbi tarifën për ofrimin e shërbimeve", në shkresën e Koordinatorit të Qendrës së Trajnimit të Vazhduar me nr. 350 prot., datë 17.02.2026 "Kërkesë për miratimin e tarifës për një orë trajnimi /parapërgatitje/ raportim/koordinim për trajnime për zhvillim profesional", në Vendimin e Rektoratit nr 34 datë 18.02.2026, në Vendimin e Senatit Akademik nr 15 dt 19.02.2026, në Relacionin e Administratorit nr 362 prot dt 18.02.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.02.2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë tarifën, për një orë trajnimi /parapërgatitje/ raportim/koordinim për trajnime për zhvillim profesional në shumën 1400 lekë sipas tabelës bashkëlidhur;
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**



1. Rubrika: Trajnime, tryeza të rrumbullakëta, përgatitje, raportim për trajnime, koordinim i trajnimeve etj.		
Përshkrimi i rubrikës	Një orë trajnimi / parapërgatitje / raportim / koordinim	Vlera në lekë
Trajnime me punonjës arsimorë	1 orë trajnim	650
Përgatitje për trajnim	Për 1 orë trajnim	300
Raportime për trajnim	Për 1 orë trajnim	150
Koordinim i trajnimeve	Për 1 orë trajnim	250
2. Rubrika: Fotokopje, printime, kancelari		
Përshkrimi i rubrikës	Printim / fotokopje / kancelari për një person	Vlera në lekë
Printime fletë pune	Paketë materiale për 1 pjesëmarrës	50
<b>Totali për 1 orë trajnim</b>		<b>1,400 lekë</b>